



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 17.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 14.01.2025, të parashtruar nga O. E. TONI INGJINJERINGLLapushnik, Magjistrerja, M9, Llapushnik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra, me Nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1nxjerr:

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori ekonomik TONI INGJINJERINGLLapushnik, Magjistrerja, M9, Llapushnik, të dt; 14.01.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit, “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra, me Nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1.

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për ELEKTRIKA-MONT SHPK Lipjan.

Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 09.01.2025

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik e TONI INGJINJERINGLLapushnik, Magjistrerja, M9, Llapushnik, me dt. 14.01.2025, ka paraqitur kërkesë për Ri-Shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra, me Nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1, kundër vendimi të Autoritetit Kontraktues **për shpërblim me kontratë** të datës: 09.01.2025.

Autoriteti Kontraktues, me datë 17.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:
Sa i përket pretendimit të tenderuesit ankues se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka në mardhënie pune një ing të moshës mbi 65 qendron, por nuk qendron pretendimi i OE ankues se i njeiti nuk mund të jetë në mardhënie pune, nuk qëndron për arsyes se sa i përket moshës së

ing që kontestohet nga tenderuesi ankues nuk qëndron për arsye se ligji nuk e ndalon për të punuar pas moshës 65 vjet e sidomos për profesionet deficitare siç janë ing.

Sa i përket pretendimit të tenderuesit ankues se nuk ka në mardhenie pune një ing siq është kërkuar në dosje të tenderit nuk qëndron për arsye siq edhe ju vet e e keni nënvizuar shihet se diploma është me titull automatikë me elektronikë. Ky pretendim është tërësisht i pa bazë sepse në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit nuk është kërkuar që diploma të jetë e noterizuar. E kjo është e rregulluar dhe me nenin 26 të RRPP 001/2022, Verisoni i konsoliduar i dt;11.11.2024.

Pretendimi i dytë se asnjë punëtorë nuk e ka me kontratë as ky pretendim nuk qëndron për arsye se në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit është ,citat: **Deshmia 2. Lista e stafit duhet të dorzohet e nënshkruar dhe e vulosur nga OE e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbiemrin, Profesionin. Vendimi apo deklarata për emrimin e Menaxherit e këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Për piken (A dhe B), duhet të dëshmojnë me Diplome dhe CV, Për piken (C) të dëshmojnë me certifikata sipas kërkeses, Për piken (D) të dëshmojnë me diplome, Për piken (E) të dëshmojnë me certifikate sipas kërkeses. Për të gjithë stafin kerkohen Kontratat e punes ose parakontratat e punës me validitet. Siq shihet nga kjo kërkohet kontratë ose parakontratë që dmth. Autoriteti kontraktues , respektivisht komisioni i vlerësimit i është përmbajete kërkesave në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit.**

Sa i përket pretendimit se tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk e ka sjellë vertetimin e ATK-së siq kërkohet në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit as ky pretendim nuk qëndron për arsye se në dosje të tenderit nuk specifikohet se nëse është në marrveshje duhet të bashkangjitet marrëveshja, ndërsa sa i përket se është në marrveshje për pagim të borgjit në rastet e tilla ne kemi pasur rast edhe më heret dhe jemi konsultuar drejt për drejt me ATK dhe na është rekomanduar se nëse na paraqitet një vertetim se një opetar ekonomik është në marrveshje për pagimin e borgjit të ATK-së atëherë ky duhet të pranohet si i mirëqenë.

Sa i përket pretendimit të tjetër se operatori i rekomanduar për kontratë nga AK ka çmime jo normalisht të ulta ky pretendim nuk qëndron për arsye se të gjitha ofertat e pranuar kanë laramani të çmimeve në pozicione të ndryshme.

Sa i përket pretendimit tjetër në lidhje me Nenin 7- Barazia në trajtim/Jo-Diskriminimi dhe transparenca, ky pretendim nuk qëndron për arsye se Autoriteti Kontraktues perkatesishte komisioni i vlerësimit konsideron se ka vepruar konforme kërkesave dhe dëshmime të kërkuara në baze të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë për këto aktivitet të prokurimit, si dhe duke i'u përmbajtur dispozitave ligjore të LPP-se. AK me këto rast konsideron se për këto aktivitet të prokurimit ka nxjerr vendim të drejt, të arsyeshëm dhe meritues duke i'u përmbajtur nenit 7, paragrafeve 1, 2 dhe 4 të LPP-se, i cili garanton trajtim të barabartë, jo diskriminues, transparentë dhe konkurrues në mes të Operatoreve Ekonomik.

Sa i përket pretendimit tjetër në lidhje me Nenin 59 - Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, edhe ky pretendim nuk qëndron për arsye se Autoriteti Kontraktues në baze të dispozitave ligjore të LPP-se perkatesishte nenit 59 ka kërkuar sqarime shpesh me anë të letrës standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit nga të gjithë Operatorët Ekonomik mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i

tenderëve dhe duke ju përmbajtur dispozitave ligjore të LPP-se në bazë të neni 59 të këtij ligji.

Sa i përket pretendimit tjetër në lidhje me Neni 60 Kriteret për Dhënie të Kontratës, pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se AK në bazë të paragrafit 1.1 të këtij neni ka rekomanduar për kontratë OE me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Bekim Shabani, Drejtor i drejtorisë së Prokurimit

